



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 16/2 Prot.

Tiranë, më 14/12/2010

Lënda: Rekomandim për **Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.**

REKOMANDIM

Nr. 16/2, datë 14/12/2010

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit **Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.**

KONSTATOVA

Më datë 18.10.2010 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- A njihet ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “ *Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, ç’masa janë marrë për implementimin e tij.
- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, pedagogë, studentë, punonjës etj.).
- Nëse e njohin detyrimin për të njoftuar të dhënat personale që përpunojnë tek Komisioneri, në ç’skallë dhe si veprohet.
- Për këto të dhëna a zbatohen kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”.
- A njihen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale dhe si zbatohen ato?
- Ç’masa merren për sigurinë e dokumentacionit për të dhënat personale? Nëse kanë rregullore të veçantë për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale ose të ketë rregulla që janë përfshirë në rregulloren e brendshme.

- Nëse ka instalime të kamerave vëzhguese, si ato përdoren dhe a ka paralajmërime për përdorimin e tyre.

Komisioneri *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

1) Kontrolluesi Fakulteti i Drejtësisë nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të dhënave personale”*, *“...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.”.*

2) Kontrolluesi Fakulteti i Drejtësisë, në zbatim të neneve 27/2 “c” dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* nuk është shprehur në rregulloret e brendshme të hartuara prej tij lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale.

- Nuk është zbatuar neni 27/2 “c”... *“udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave”*...
- Nuk është zbatuar neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, *“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.*

3) Kontrolluesi Fakulteti i Drejtësisë nuk është shprehur në ndonjë dokument ligjor, si rregullorja e Fakultetit, dhe nuk ka rregulla të qarta në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave personale sipas qëllimit për të cilin këto të dhëna janë mbledhur në zbatim të nenit 27 pika 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të dhënave personale”*. Kështu nga ky kontrollues mbahen për një afat kohor të pacaktuar dosje të stafit akademik ose personelit edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës pranë këtij Fakulteti.

- Nuk respektohet neni 27/4 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*...*“Dokumentacioni i të dhënave mbahet për atë kohë sa është i nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar”.*

- Nuk është zbatuar neni 5 pika1/d i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”...“Në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.

- 4) Kontrolluesi Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës bën publike rezultatet e provimeve të studentëve dhe emrat përkatës në ambjentet e fakultetit dhe kjo bën të mundur që kushdo person të ketë akses ndaj këtyre rezultateve, ç’farë përbën një shkelje të privatësisë për studentët dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” brenda datës 31.12.2010, të plotësohet detyrimi lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të hartohet rregullore e brendshme ose të përfshihet në rregullore seksioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin.
3. Në zbatim të neneve 5 dhe 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, të përcaktohen rregulla të qarta në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave personale sipas qëllimit për të cilin këto të dhëna mbliidhen.
4. Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të aplikohen mënyra alternative për informimin e studentëve në lidhje me rezultatet e provimeve që zhvillohen pranë këtij Fakulteti si edhe të gjitha rezultateve të tjera të cilat mund të zbulojnë identitetin e subjekteve të të dhënave.
5. Në zbatim të neneve 8, 9 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të përmbushet detyrimi në lidhje me transferimet e të dhënave për studentët ose stafin akademik në shtete të tjera, që këto transferime taksativisht të kryhen me autorizim të Komisionerit, në rastet kur transferimi i të dhënave personale realizohet tek një shtet i cili nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej dy muajsh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

